

V E N D I M
Nr.406, datë 17.8.1993

PËR RIORGANIZIMIN E SHËRBIMIT TË MBROJTJES SË BIMËVE

(Ndryshuar me VKM nr. 9, datë 12.1.2001; nr. 376, datë 23.7.2002)

(i përditësuar)

Në zbatim të ligjit nr. 7662, datë 19.1.1993 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit krijohet Drejtoria e shërbimit të mbrojtjes së bimëve, brenda së cilës ngrihet dhe funksionon Inspektoriati i mbrojtjes së bimëve dhe karantinës dhe Sekretaria e Komisionit Shtetëror të Pesticideve.

2. Në Drejtorinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, në çdo rreth, caktohen inspektorët e mbrojtjes së bimëve, numri i të cilëve përcaktohet në përputhje me aktet nënligjore, për miratimin e organikave dhe të numrit të punonjësve.

Laboratorët e mbrojtjes së bimëve ngrihen dhe funksionojnë mbi bazë zonale. Numri i zonave dhe vendndodhja e laboratorëve përcaktohet me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

3. Në pikat doganore kufitare të caktuara për hyrjen e bimëve, të produkteve bimore e pesticideve vendosen inspektorët e karantinës së jashtme, brenda numrit të punonjësve në organikë të miratuar për sistemin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit. Në pikat doganore me veprimtari 16-orëshe shërbimi i karantinës organizohet me dy ndërresa.

Inspektorët e karantinës së jashtme bimore e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pikat doganore, kufitare. Ata janë pjesëtarë të grupit të praktikës, që bën kontaktin e parë. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të bashkërendojë punën me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave dhe Ministrinë e Rendit Publik për t'u siguruar atyre kushte normale pune.

4. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit përcakton uniformën dhe shenjën dalluese të shërbimit të karantinës bimore të Republikës së Shqipërisë dhe pajis me to inspektorët përkatës.

5. Pagesat për regjistrimin e PMB-ve bëhen nga subjektet e interesuara, në llogarinë rrjedhëse të Institutit të Mbrojtjes së Bimëve, siaps tarifave të përcaktuara në vendimin nr.72, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së produkteve për mbrojtjen e bimëve".

Me të ardhurat e realizuara nga këto pagesa, Instituti i Mbrojtjes së Bimëve përballon shpenzimet administrative të regjistrimit të PMB-ve, shpenzimet për analizat cilësore të tyre gjatë procedurave të regjistrimit dhe, pas hedhjes në treg, shpenzimet për kryerjen e provave biologjiko -agronomike dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Regjistrimit të PMB-ve, sipas përcaktimit që bën Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit me udhëzim të veçantë.

6. Shfuqizuar.

7. Në të gjitha strukturat e shërbimit të mbrojtjes së bimëve caktohen specialistë me kualifikimin përkatës.

8. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit përcakton tarifat për lëshimin e licencave, të çertifikatave fitosanitare etj. dhe analizat laboratorike.

9. Pagesat për shpenzimet administrative të regjistrimit të PMB-ve, shpenzimet për analizat cilësore të tyre, gjatë procedurave të regjistrimit dhe pas hedhjes në treg, dhe shpenzimet për kryerjen e provave biologjike-agronomike bëhen nga llogaria e thesarit për Institutin e Mbrojtjes së Bimëve. Ato administrohen sipas akteve, ligjore dhe nënligjore, në

fuqi, për investime dhe shërbime operative në laboratorin e kontrollit cilësor shtetëror të PMB-ve dhe për shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Regjistrimit të PMB-ve.

10. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të nxjerrë rregulla të hollësishme për detyrat e organeve të shërbimit të mbrojtjes së bimëve dhe të karantinës bimore.

11. Pesticidet që përdoren në bujqësi, nuk i nënshtrohen rregullave të caktuara në urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr.4, datë 15.9.1976 "Për lëndët plasëse dhe helmet me efekt të fortë".

12. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, të përgatitë rregulloren për importimin, ruajtjen, transportimin, tregtimin, përdorimin dhe asgjësimin e pesticideve që përdoren në bujqësi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi